
POSTIM ARKIVOR

Hafiz Musa Dërguti (1888 -1961)



SEKSIONI

Klerikë

PERIUDHA

1944 - 1944

Klerik i lartë mysliman. Lindur në një familje qytetare shkodrane më 3 mars 1888. Mësimet fillestare i mori në shkollën fillore fetare “Ndocej” dhe arsimin e mesëm në Medresenë e Pazarit. Studimet për teologji dhe filozofi i përfundoi në Medresenë e Lartë të Stambollit, pas të cilave u emërua hoxhë në Xhaminë e Efendisë në Shkodër. Në vitet 1920–1924 u përfshi në veprimtari politike opozitare. Pas përmbysjes së qeverisë së Fan Noli, u arrestua për dy muaj dhe më pas u lirua me ndërhyrjen e klerit mysliman. Gjatë pushtimit u konsiderua figurë e rrezikshme nga qarqet komuniste të Shkodrës, për shkak të qëndrimeve të tij publike në shtyp. Në vitin 1945 u arrestua tri herë dhe u mbajt nën mbikëqyrje. Më 11 shtator 1946 u arrestua sërish në lidhje me Lëvizjen e Postribës. Në Gjyqin Ushtarak të 27 nëntorit 1947 u dënua me 10 vjet burg.


Seksioni 1

Hafiz Musa Dërguti paraqitet në dokumentacionin gjyqësor të pasluftës si një ndër figurat e përfshira në ndjekjet penale me karakter politik në Shqipëria.Që prej vitit 1945, ai vihet nën mbikëqyrje të vazhdueshme dhe arrestohet tri herë. Më 11 shtator 1946 arrestohet sërish, kësaj here në lidhje me Lëvizja e Postribës, duke iu nënshtruar hetuesisë së shoqëruar me tortura.Më 27 nëntor 1947, Gjykata Ushtarake e Shkodrës e përfshin në një proces kolektiv me 22 të pandehur, ku shpallet fajtor si “armik i popullit” dhe dënohet me 10 vjet burgim dhe heqje të të drejtave civile. Dokumentet gjyqësore tregojnë një strukturë tipike të kohës: në fillim paraqitet akuza kolektive dhe masa e kërkuar (deri në 14 vjet burg me punë të detyruar), ndërsa individualizimi i përgjegjësisë shfaqet vetëm në vijim.Ndaj tij rëndojnë akuza për bashkëpunim gjatë periudhës së pushtimit dhe lidhje me elementë të konsideruar armiqësorë, përfshirë Riza Dani. Megjithatë, në qëndrimin e tij ai pranon vetëm pjesërisht disa rrethana dhe mohon rol aktiv në veprimtaritë e atribuuara. Dënimin e vuan fillimisht në Shkodër dhe më pas në Burgu i Burrelit, ku përballet me ndalime të praktikave fetare dhe masa disiplinore. Lirohet në moshën 66-vjeçare.

MEDIA #1

Dënimi

MEDIA FAQE #1



Zotrinj Gjyqtare.

Ne mbeledhjen t'usj sekrete ju do te merrni nje e nga nje keta kriminele per te peshuare aktivitetin dhe fajin e se cilit,dhe per te dhene denimin e merituare.Sigurisht juve qe do te vendosni per denimin e se cilit do t'a shifni fajin e se cilit me denim qe kn bere,ne rrethanat mentalitetin,rrezikeshmenin shoqnore atjera;per nes harremi ne edhe ata qe mund te duken se knne bere me pak faj,dhe ata kane tradhetuare Atdheun dhe popullin,kane tradhetuare Republiken Popullore.

Populli ka drejtuare syte nga ju Zotrinj gjyqtare,dhe pret ne besim te plote denimin e merituare per keta qe kane bere tradhetin me te shentuare.

Ne cilesin t'eme si Prokuror i Popullit kerkoj:

Te cilesohen fajtore ne baze te neneve 2a 3 ipka:1,2,7,8,9,10, 13 e 14 te Ligjes Nr.372 mbi fajte kundra Shtetit dhe Popullit dhe ne baze te nenit 4 po te kesaj ligje kerkoj denimin e tyre si vijon:

1)Per te pandehurit:1)Dalo Kalin, emsinjor Volaj,Bilbil Hajnin, Xhelal Nerdellin,Gin Serreqin,Kolkip Koten,Osman Haxhin,Shaban Abdullahim dhe Isa Koten me VDEKJE.

2)Per te pandehurit:1)Pedro Curashin,Abas Kysin,Kyrto Danin, Jakup Danin me BURGIM TE PERJETSHEM.

3)Per te pandehurit:1)Durja Anamali,Nuh Duli me nga 20 vjet privim lirie e pune te detyruare.

4)Per te pandehurit:1)Sami Nepishti,Hafis Derguti,Sulo Kurti dhe Hajdar Tafa me nga 20 vjet privim lirie e pune te detyruare.

5) Per te pandehurin Tom Paloka me 10 vjet privim lriee e pune te detyruare.

6)Per te pandehurit Abas Sulejmanin dhe Taf Kysenjin me nga 5 vjet privim lirie e pune te detyruare.

Gjithashtu kerkoj te vendosat edhe konfiskimi pasunise se tyre te tundeshme dhe te patundeshme.

PROKUROR UCHTARAKE Z.U.SH.
Kapiten Ll.te
(Nexhat Qemali)

Shkodre,me 25/XI/947

MOSH

Dënimi

INFORMACION

Dënimi

DOSJA	Hetimore-Gjyqësore
NR.	1297-A
	421
GJUHA	Shqip


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #2

Akuza e Musa Dërgutit

MEDIA FAQE #1



Akuza e Musa Dërgutit

INFORMACION

Akuza e Musa Dërgutit


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #3

Shtesë procesi Hafiz Musa Dërguti

MEDIA FAQE #1



Vdekje Fashizmit Liri Popullit

Shtes Proçesi Hafis Musa Dergutit

Per arsye se Musa Derguti nuk pranon që tiket folur Kadri Metit për Sulmin që ju be Shkodrës në daten 9/XI/46 u pa nevoja ballafaqimit dhe u th me daten 24/11/46,Kadri Meti dhe u ballafaqua me Hafis Musa Dergutin ku dek laron nder sy të tij sa ma poshtë vijon. - - - - - - - - - - - - - - - - - -

P.P.Hafis Musa Dergutin e njof tash dy vjet ,na kemi patur nji grindje me Muharrem Seitim ky ka ardhur me na rregullue.Në verenx e kaluar Musa Dergut ka pasë qitë fëmijt e vëllaut tija në Muriq në katundin t'onë. - - - - - - -

P.P.Hafis Derguti ka ardhë disa herë atje une e kam par dy her një her jem pa në shtëpin e Seit Beqos e gjeta atje mbasi kisha shku për të mbledhur Rinin do vejshe në nji katund tjetër.Hafizi na foli atje çeshtje Partinash duke thenur që këjo qeveri do të ndryshojë do të vijë tjetër qeveri edhe Riza Dani bile më tha mua që ka qenur andej edhe është kthyer .- - - - - -

P.P.Të Diel në mengjes heret dat 8/9/46 që naten u ba çeshtje e Shkodrës Hafis Derguti erdhi atje mbasi na kishin vdekur disa fëmij per ngushllim me u pjekë une kishe vaditur gjith naten nji bostan dhe në mengjes më kish zenur gjumi,kur vjen hoxha grueja e ime vjen në dhomen tjetër dhe më çon duke thenur çou se ka ardhë një hoxhë që rri në shtëpi të Ramadanit dhe une u çova shkova në dhomë tjetër aty gjeta hoxhen ,i fola osh gjelden si je si shkon edhe ky më tha fjalët e tija pastaj më ngushlloi për fëmijët që na kishin vdekur.Më tht skam kohë me ndenjë shum mbasi due me u nis heret mbasi do marr familjen sot.Por më thotë mua tash more djalë ka ardhur puna me të janë ba Shkodra e Malet vllazen janë bashku të tan dhe do ti biem ta zhdukim këte qeveri mor hoxhë se mas ta merrni hallkun në qafë,mos kini gaj le se është puna e kryeme mos u beni të marrë.Prandej më tha i gjith populli duhet të jetë i pregatitur e kur ta lajmërojmë na të dalin më supata e kmes kush nuk ka pushkë.Aj që të mos dalë është bashkëpunus me qeverin (Komunista Mbasi Partin Komuniste do ta zhdukim kreit nuk do tu lem rrac as gra as fëmij prandej edhe ata që nuk do të dalin kështu do ta pësojnë.Ikemi për të pyetur as Komandant as një Prandej pritni lajmin tonë.- - - - - - - - - - - - -

P.P.Me këto fjalë u ngreh dhe doli nuk piu as kafe nuk na çuan as një la lajmPo të na kish ardhur lajm do kishim dalur por nuk na erdhi një tjetër kur her sjam pjekë ma me Hafis Dergutin këte fjal që them këtu janë të gjitha të thanura nga goja Hafis Musa Dergutit.Shtoj se më k thenur në rradhë të fundit që e kish porositur edhe Riza Dani që kthen tek Kadriu per mua dhe th thuaji që une jam miku i gjithmonshëm i atyre e baj dhe un pjesë në këte çeshtje po të marr dhe Kadrim.Këto fjalë Hafis mi ke thenur ti them këtu e ti them në gjyq.Persa përmban proçesi mbasi mu këndue me ze të nalt pranoj që që janë të gjitha të verteta dhe i vertetoj me gishtin e dorës djathtë. - - -

Dekraruesi (Kadri Meti)

Oficeri Pyetës (Kap.i I-rë Abdyl Hakiu)

Shtesë procesi Hafiz Musa Dërguti

INFORMACION

Shtesë procesi Hafiz Musa Dërguti

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.